



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Gramsh, më 30/05/2023



Prot. Thirrje për mbledhjen e parë të konstituimit të organeve të Qeverisjes Vendore të Bashkisë Gramsh

Të nderuar këshilltarë,
Në mbështetje të nenit 48 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 2 e Rregullores “Për funksionimin e Këshillit Bashkiak Gramsh”, njoftoj se **ditën e Hënë datë 05/06/2023 ora 10:00** në sallën e mbledhjeve të Këshillit ,do të zhvillohet mbledhja konstituive e organeve të qeverisjes vendore të Bashkisë Gramsh dalë nga zgjedhjet 14/05/2023 , me rend dite si më poshtë:

1- Fjala e hapjes dhe njohja me Vendimin e KQZ për përbërjen e Këshillit sipas forcës politike.

(Sekretari i Këshillit)

a) Përshëndetje e rastit (Përfaqësues i prefekturës, Qeverise etj..)

2- Konstituimi i Këshillit(Drejtimi i mbledhjes nga këshilltari më i vjetër në moshë).

- a) Zgjedhja e Komisionit të Vërtetimit të Mandateve.
- b) Shqyrtimi dhe miratimi i projekt/raportit të Komisionit të Mandateve.
- c) Betimi dhe nënshkrimi i betimit nga Këshilltarët.

3- Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak.

- a) Propozimi i kandidatëve nga këshilltarët e partive politike dhe prezantim i shkurtër i tyre.
- b) Ngritja e Komisionit të Votimit(si rregull 3 anëtarë).
- c) Përgatitja e fletëve të votimit,procedurave,realizimi i votimit të fshehtë.
- d) Shpallja e rezultatit të votimit dhe kalimi i drejtimit të mbledhjes tek Kryetari i Këshillit i sapozgjedhur.

4- Zgjedhja e Zëvendëskryetarit/ve të Këshillit Bashkiak.

- a) Miratimi me votim të hapur i numrit të nënkryetarëve të Këshillit.
- b) Propozimi i kandidatëve për nënkryetarë Këshilli.
- c) Përgatitja e procedurave të votimit, kryerja e votimit.
- d) Shpallja e rezultateve të votimit.

5- Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë.

- a) Leximi i vendimit të Gjykatës për vlefshmërinë e mandatit.
- b) Betimi i Kryetarit dhe nënshkrimi i aktit të Betimit.
- c) Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Bashkisë.
- d) Nënshkrimi i protokollit të marrjes në dorëzim të detyrës.

6- Zgjedhja e Këshilltarëve që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut.

- a) Leximi i Shkresës së Prefektit për numrin e përfaqësuesve të Këshillit të Bashkisë në Këshillin e Qarkut nga Sekretari i Këshillit.
- b) Paraqitja e propozimeve nga Këshilltarët.
- c) Përgatitja e procedurave të votimit, kryerja e votimit.
- d) Shpallja e rezultatit.

7- Mbyllja e mbledhjes

Duke ju falenderuar!

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Xhulia Gjini

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Xhulia Gjini', with a stylized flourish and a question mark at the end.